



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 1367. Prot

Gjirokastrë, më 18/11/2021

Lënda: Hapet thirrja për aplikim për bursa studimi të cikleve Master dhe Doktoraturë në Universitetin Mohamed bin Zayes të Inteligjencës Artificiale (MBZUAI).

Universiteti Mohamed bin Zayes i Inteligjencës Artificiale (MBZUAI) ofron bursa studimi për studentët e ekselencës, për studime pasuniversitare master dhe doktoraturë.

Ky universitet është themeluar në vitin 2019 dhe ofron programe në fushën e Inteligjencës Artificiale për studentët vendas dhe ndërkombëtarë. Themelimi i "MBZUAI" është pjesë e strategjisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për Inteligjencën Artificiale 2031.

Procesi i përzgjedhjes së studentëve ndjek një procedurë tepër rigorozë, ku standard është merita dhe njohuritë. Në momentin e pranimit prej palës pritëse studentit i ofrohet bursë e plotë pranimi, e cila përfshin:

- akomodimin;
- biletat vjetore të udhëtimit;
- sigurimin shëndetësor;
- pagesën mujore monetare në vlerën 8000 derhem (2000 euro) për nivelin master dhe 10000 derhem (2500 euro) për nivelin doktoraturë.

Vlen për t'u theksuar se, në momentin që studenti fiton të drejtën e kësaj burse bashkë me të lind edhe detyrimi i kthimit në atdhe në momentin e përfundimit të saj, çdo shkelje e këtij detyrimi sjell sanksione tek individët. Detaje të tjera në lidhje me universitetin i gjeni në linkun e mëposhtëm:

<https://mbzuai.ac.ae/>

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

